

VENDIM
Nr. 758, datë 20.12.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË AUTORITETIT KOMPETENT,
PËR REALIZIMIN E RITJES SË PËRGJITHSHME TË KAPITALIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BANKËN NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 2, të ligjit nr. 4/2023, “Për miratimin e rezolutave nr. 663, ‘Rritja e përgjithshme e kapitalit GCI’, dhe nr. 664, ‘Rritja selektive e kapitalit SCI’, të vitit 2018, të Këshillit të Guvernatorëve të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD)”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kompetent për realizimin e rritjes së përgjithshme të kapitalit të Republikës së Shqipërisë në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) (në vijim Banka) është Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
 2. Ministria e Financave dhe Ekonomisë autorizohet të komunikojë me Bankën për përcaktimin e dokumentacionit dhe mënyrën e kryerjes së pagesës.
 3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë plotëson dokumentacionin e kërkuar nga Banka dhe kryen pagesën, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
 4. Ministri i Drejtësisë, si pjesë e dokumentacionit të kërkuar nga Banka, lëshon një dokument të titulluar “Memorandum i ligjit”, për të konfirmuar se janë ndërmarrë të gjitha hapat ligjorë për të përmbushur detyrimet që burojnë nga rritja e kapitalit.
 5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama